

KONTRATE
"MBI THEMELIMIN E SHOQËRISË SË THJESHTË"
" Stevia "

Sot, më datë 18/03/2022 , në Tiranë, Shqipëri, personi i mëposhtëm:


Z. Stiven Faslia , shtetas shqiptar , lindur më 03/07/1998 banues në Shkoder, mbajtës i nr te identifikimit Nr . J80703087E madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar; dhe **Znj. Salina Dibra** shtetase shqiptare , lindur më 30/03/2000 banues në Shkoder, mbajtës i nr te identifikimit Nr . K05330070V madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, vendosen të themelojnë një shoqëri të thjeshtë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe me dispozitat në vijim:

TE PERGJITHSHME

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e anëtarëve themelues, marrëdhëniet e organeve të saj, ilojin e partneritetit, kohezgjatjen e veprimtarisë së shoqërisë së thjeshtë, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

Neni 1

- 1.1 Emri i shoqërisë se thjeshte është "Stevia" këtu më poshtë e quajtur "Shoqëria". Shoqëria është person juridik privat.
- 1.2 Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë se tregut dhe ka per qellim, mes të tjerave, fitimin. Shoqëria organizohet në formën e shoqërisë Se thjeshtë. Veprimtaria e saj I nënshtrohet dispozitave te kesaj kontrate themelimi dhe te legjislacionit në fuqi.



Neni 2
Adresa e shoqërisë

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Ndertesa nr. 70, Lagja Perash, Blv. Mehmet Pashe Plaku Shkoder, zona kadastrale 8594.
Shoqëria mund të hap degë dhe zyra përfaqësimi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.

Neni 3
Objekti

- 3.1 Objekti i Shoqërisë do të jetë:
Aktivitet i shërbimit të pijeve bio, lengje frutash.

Neni 4
Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pakufizuar ,duke filluar nga data e rregjistrimit ne QKB .

Neni 5
Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 50.000 Leke (njëqind mije)
- 5.2 Kapitali është shlyer nga anetaret themelues ne raportet e meposhtme:
- Nga Znj. Salina Dibra- 50% e kapitalit, me 1 kuote
 - Nga Z. Stiven Faslja - 50% te kapitalit, me 1 kuote.
- 5.3 Kapitali themeltar është nënshkruar dhe shlyer plotësisht me kontribute në para nga Anetaret me themelimin e Shoqërisë.



Neni 6
Asambleja e Përgjithshme

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me dispozitat e kësaj Kontrate, janë të detyrueshme për të gjithë Anetaret, pavarësisht janë apo jo të pranishëm në mbledhje, janë apo jo dakord me këto vendime.


Neni 7
Administratori

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administrator/ë, i/të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme.

- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:

Znj. Salina Dibra shtetase shqiptare , lindur më 30/03/2000 banues në Shkoder, mbajtës i nr te identifikimit Nr . K05330070V madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Nënshkrimi i administratorit _____

Salina Dibra 

- 7.3 Mandati i Administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Asamblesë së Përgjithshme që do të marrë vendim në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.
- 7.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori i cili është përgjegjës personalisht për shkelje të ligjit dhe të Satutit dhe për gabimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.



Neni 8
Viti Financiar


- 8.1 Viti financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 8.2 Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2022.

Neni 9
Të ndryshme

- 9.1 Kjo Kontrate Themelimi është hartuar dhe nënshkruar në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë secila.

ORTAKET E SHOQERISE:

STIVEN FASLIA

Stiven Faslia 

SALTINA DIBRA

Saltina Dibra 